

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.20/04/2022 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

LILLY MAY HUTSON, atesia Paul,shtetase britanike, e datelindjes 09/03/1999, e lindur ne Tooting,dhe banuese ne Tooting me adrese: 31 Torrington Close, Wigston, Leicestershire, LE18 2RY, madhore,me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes britanike me Nr.550713428,leshuar ne date 13/11/2017,

IAN GARRY SHAVE, atesia Garry,shtetas britanik, i datelindjes 03/06/1983, lindur ne Leicester,dhe banues ne Leicester me adrese: 31 Torrington Close, Wigston, Leicestershire, LE18 2RY, madhor,me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes britanike me Nr.125933741,leshuar ne date 17/05/2021,

te cilet me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **KodiTek** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **KodiTek** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjisllacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **KodiTek** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **KodiTek** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Qarku Vlore,Bashkia Sarande,Lagj.nr.1,Rr."Gjergj Araniti" pasuria nr.9/83+1-25, zk 8642.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Te zhvilloje aktivitet ne fushen e prodhimit dhe shitjes se software (programe kompjuterike), dizenjim dhe zhvillim, projektim i software (programe kompjuterike) dhe bazes se te dhenave, analize zhvillim, programim, integrim i komponenteve,trajtime**

instalime, konsulenca, implementime dhe te tjera ndihmese ne kete fushe, ndjekje te proceseve ,kolaudim, deri ne produktin perfundimtar duke realizuar zgjidhje informatike, plotesim i sistemit informatik me elementet e sigurise, privatesise etj, zhvillim ne kohe te ndryshme, duke garantuar permiresim te sistemit per te realizuar komunikime me versione te ndryshme te sistemit informatik,sherbime online.

- Blerje shitje Hardware, kompjutera, aksesore dhe pjese te tyre, import eksport kompjutera, hardware dhe aksesore te tjere, instalim e mirmbajtje te tyre,sherbime mirembajtje online.
- Sherbime ne fushen e hotelerise,Bar-Restorant-Plazh,sherbime turistike,operator turistik,agjensi turistike,agjensi udhetimesh turistike,marrje dhe dhenie me qira hotele dhe dhoma per qellime turistike,dhenie me qera e automjeteve dhe çdo sherbim tjetër ne fushen e turizmit.
- Importin , eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te artikujve te ndyshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfeksioneve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake ,kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime qeramike artizanati, duralumini , mekanike te lendes drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve , materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.

Neni 5

Kohezqatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 120,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 120,000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **LILLY MAY HUTSON**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 48,000 Leke, e cila perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **IAN GARRY SHAVE**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 72,000 Leke, e cila perfaqeson 60 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per ceshtje te tjera si:emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,percaktimin e shperblimeve,perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem,i cili do te jete **IAN GARRY SHAVE**, atesia Garry,shtetas britanik, i datelindjes 03/06/1983, lindur ne Leicester,dhe banues ne Leicester me adrese: 31 Torrington Close, Wigston, Leicestershire, LE18 2RY, madhor,me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes britanike me Nr.125933741,leshuar ne date 17/05/2021.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori/et kane të gjitha kompetencat për të vepruar se bashku në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori/et angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori/et ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfare do ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **KodiTek** shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Lilly Hutson



IAN SHAVE

